



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS AVOKATI I POPULLIT

**lidhur me**  
**vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë**

**Për:**           **Z. Abelard Tahiri, Ministër**  
                  **Ministria e Drejtësisë**

**Z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Përgjithshëm për Shëndetësi në Burgje,**  
                  **Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Urim Ismaili, Ministër**  
                  **Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm**  
                  **Shërbimi Korrektues i Kosovës**

**Z. Jeton Mehmetaj, u.d. drejtor**  
                  **Qendra e Korrektuese në Dubravë**

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr.05/L-019, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Prishtinë, më 24 gusht 2018

## HYRJE

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT nga 20 deri më 22 mars 2018 e ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (në tekstin e mëtejshëm “QKD”).

QKD ka filluar të ndërtohet në vitin 1976 dhe është përfunduar në vitin 1986 kur edhe është hapur. Në atë kohë kapaciteti ka qenë diku rreth 1000 të burgosur si dhe ka ekzistuar nëndega e QKD në Gurrakoc, ku më shumë kanë qenë të koncentruar të burgosurit me dënime të shkurtra të cilët kanë punuar, duke pasur parasysh se aty ka ekzistuar ferma e pulave, punëtorja e axhustatorëve, etj.<sup>1</sup> Pas luftës me hyrjen e trupave të KFOR-it dhe administratës së UNMIK-ut ky institucion filloi të administrohet nga UNMIK-u dhe të rindërtohet në saje donacioneve të huaja. Fillimisht u rindërtuan pavijonet 2,3,7 dhe 8 dhe në qershor të vitit 2000 filloi punën.

QKD është institucion i nivelit të lartë të sigurisë i përbërë prej disa sektorëve të ndryshëm. Pjesa e Brendshme është e ndarë në dy pjesë ku njëra prej tyre është zona për zhvillimin bujqësisë dhe përdorime të tjera, dhe në pjesën e banueshme, ku janë të vendosur të burgosur kryesisht të dënuar të rritur.

Zakonisht të burgosurit janë të vendosur në 8 pavijone banimi, por gjatë vizitës MKPT u njoftua se pavijoni 4 ishte duke u rinovuar, ndërsa në pavijonin e spitalit janë të vendosur pacientët ku u ofrohet ndihma mjekësore, përpos rasteve të rënda të cilat dërgohen në spitalet publike. Jashtë murit rrethues të Burgut gjendet pavijoni gjysmë i hapur ku janë të vendosur të burgosur të rrezikshmërisë së ultë të cilët kanë përcjellje minimale. Kapaciteti i QKD është 1183 shtretër.

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të të dënuar të cilët gjendeshin në këtë qendër në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Gjatë vizitës, në veçanti janë trajtuar çështja e procedurave të pranimit, njohja e të burgosurve me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e akomodimit, regjimi, kujdesi shëndetësor, raportet ndërmjet të burgosurve, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore të cilat mund t’u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

Më 29 maj 2018, MKPT pati takim zyrtar me Drejtorin e Shërbimit Korrektues të Kosovës Z. Nehat Thaçi, me ç’ rast e njoftoi për të gjeturat dhe rekomandimet nga vizita e lartpërmendur.

---

<sup>1</sup> Të dhëna nga ueb faqja e Ministrisë së Drejtësisë e Republikës së Kosovës, në: <http://www.md-ks.net/?page=1.70> (21.5. 2016).

## **Përbërja e grupit monitorues**

1. Ekipi i MKPT, si dhe vëzhguesit:
  - 1) Ylber Topalli, Kryeinspektor i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë (vëzhgues).
  - 2) Jim McManus (ekspert i Këshillit të Evropës, në cilësi të vëzhguesit)
  - 3) Trevor Stevens (ekspert i Këshillit të Evropës, në cilësi të vëzhguesit)
2. **Në kohën kur MKPT e vizitoi këtë qendër ishin të vendosur 938 të burgosur.** Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës e ka vizituar QKD në vitin 2007, 2010 dhe 2015.

## **Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës**

3. Gjatë vizitës së MKPT në QKD, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit i u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

## **Keqtrajtimi fizik**

4. Gjatë vizitës në këtë qendër, MKPT nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës nga zyrtarët korrektues. Ekipi monitorues ka pranuar dy ankesa nga dy të burgosur me pretendimin se janë keqtrajtuar fizikisht nga zyrtarët e Policisë së Kosovës në kohën kur u arrestuan dhe u dërguan në stacionet policore ku u intervistuan.
5. Në rastin e ankuesit B.D, ankuesi pohoi se është keqtrajtuar fizikisht nga zyrtarët policor gjatë intervistimit dhe transportimit në stacionin policor në Prizren duke u goditur me grushte. Sipas pohimeve të ankuesit lidhur me këtë ai e njoftoi gjyqtarin e procedurës paraprake, por nuk u ndërmor asgjë. Po ashtu ankuesi pohoi se nuk ka ushtruar kurrë ankesë pranë Policisë së Kosovës apo Inspektoratit Policor të Kosovës. Ankuesi R.S pohoi se ai u keqtrajtua fizikisht në stacionin policor në Ferizaj dhe se lidhur me këtë kishte ushtruar ankesë pranë Inspektoratit Policor të Kosovës një muaj më parë.
6. Lidhur me këtë ankesë, MKPT e Avokatit të Popullit kërkon nga Inspektorati Policor të njoftohet me hetimet e zhvilluara, si dhe konstatimet e këtij organi.
7. Ekipi monitorues po ashtu ka vizituar edhe të burgosurit të cilëve iu shqiptua masa disiplinore e vetmisë dhe të cilët ishin të vendosur në qeli të caktuara ku mbaheshin si pasojë e masës së shqiptuar. **MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës apo shkelje të të drejtave tjera të cilat u takojnë personave në fjalë.**

## **Ankesat për korrupsion dhe favorizime**

8. Ekipi monitorues ka pranuar një numër të konsiderueshëm të pohimeve nga të burgosurit për korrupsion dhe favorizime që përfshijnë jo vetëm personelin korrektues, por edhe personelin shëndetësor. Sipas këtyre pohimeve, bazuar në një pagesë të caktuar të

parave, të burgosurit mund të përfitojnë trajtim favorizues sa i përket mundësive për të punuar, vizita familjare, largim të përkohshëm jashtë institucionit, trajtim mjekësor etj. MKPT po ashtu ka pranuar një numër të pohimeve nga të burgosurit sipas të cilëve, të burgosurit e caktuar të kategorive të caktuara, trajtohen me favorizime krahasuar me të burgosurit tjerë.

9. **Duke mos paragjykuar nëse pohimet e tilla janë të vërteta apo jo, MKPT konsideron se drejtoria e QKD dhe organet kompetente të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) duhet të zhvillojnë hetime gjithëpërfshirëse dhe të pavarura sa herë që ka pohime për korrupsion dhe favorizime në QKD.** Autoritetet në fjalë duhet të forcojnë përpjekjet e tyre për të luftuar këto fenomene përmes masave preventive, edukimit dhe aplikimit të sanksioneve adekuate.
10. Po ashtu, MKPT vëren se neni 5 paragrafi 3 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton miratimin e legjislacionit dytësor me qëllim të eliminimit të korrupsionit. Prandaj përmes këtij raporti MKPT do të kërkojë nga organet kompetente të njoftohet nëse legjislacioni në fjalë është miratuar.

## **Kushtet materiale**

### **Ushqimi**

11. Gjatë vizitës në QKD, MKPT ka pranuar një numër të madh të ankesave lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit i cili u servohet të burgosurve. **Të burgosurit pohuan se cilësia dhe sasia e ushqimit që u shërbehet për mëngjes dhe darkë është shumë e varfër.**
12. MKPT vëren se Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë në ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe fuqisë së tij në tri shujta për çdo ditë të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe për aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Po ashtu, ky ligj përcakton obligimin që të dënuarit ti sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.<sup>2</sup>
13. Gjatë vizitës në kuzhinë MKPT ka vërejtur se janë të angazhuar në punë 6 kuzhinier, shefi i kuzhinës, një furrtares, një punëtor i depos me 34 të burgosur të angazhuar në punë tjera ndihmëse në kuzhinë, 12 të burgosur të angazhuar në furrë (pjekje buke) dhe 3 për pastrim dhe mbajtje higjienë në kuzhinë. Të angazhuarit në punë, përfshirë këtu edhe të burgosurit, janë të pajisur me librezë adekuate sanitare të cilat janë valide deri në muajin prill 2018. MKPT konstatoi se depoja ku mbahet ushqimi afatgjatë ishte në gjendje të mirë dhe posedon kushtet që nevojiten për ruajtje të ushqimit dhe po ashtu nuk ka lagështi. **Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur mungesë të menyve dietale për personat të cilët vuajnë nga sëmundja e diabetit.**
14. **MKPT rithekson si edhe në raportet tjera, obligimin e autoriteteve kompetente për të siguruar furnizime të pandërprera me ushqim dietal sipas rekomandimeve të mjekut.** MKPT u informua se kuzhina përballet me mungesa të pajisjeve për zierje dhe pjekje të ushqimit, lugët plastike për ushqim për të burgosur nuk janë te mjaftueshme, po

---

<sup>2</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

ashtu edhe për enë speciale që dedikohen për bartjen e ushqimit në pavijone dhe ruajtjen e nxehtësisë së ushqimit.

15. Transporti i ushqimit bëhet me mjete jo adekuate e shpesh edhe me traktorë. Po ashtu, ka mungesa të inventarit, uniformave, dorëzave për punë. Është vërejtur se as stafi e as të burgosurit nuk kanë veshje adekuate të punës për kuzhinë (përdorin qese bërlloku si përparëse ose mbathje në këmbë për mos t'u lagur nga uji gjatë larjes së enëve apo kryerjes së punëve në kuzhinë), nuk kanë sapun të lëngët për mbajtjen e higjienës së personelit në kuzhinë gjatë punës (duarve), kurse pajisjet të cilat i kishin në dispozicion, ishin me defekte teknike.
16. MKPT ka pranuar ankesa nga të burgosurit lidhur me orarin e shpërndarjes së ushqimit. Sipas të burgosurve distanca kohore e vakteve të shpërndarjes së ushqimit është mjaft e ngushtë (8.30- 9.30 mëngjesi, 10.30-12 dreka, 15-16 darka) kur përfundon gjithçka me servimin e ushqimit. Po ashtu, MKPT e konsideron shqetësuese informatën se kontejnerët me mbeturina largohen pas 2-3 ditësh. Po ashtu, është shqetësuese fakti që aty grumbullohen qentë endacakë dhe mbeturinat ishin shpërndarë nëpër oborrin pas kuzhinës. Banjat dhe dushi në kuzhinë nuk i plotësojnë as kushtet minimale për përdorim. Është vërejtur se disa pajisje të furrës nuk mbyllën mirë dhe shpesh kanë probleme në funksionim. Furnizimi me mjete për gatim të bukës ishte i mirë, i rregullt dhe me afat.
17. MKPT ka vërejtur se hapësira e cila përdorej për lavanteri nuk kishte dritë natyrore, ishte pa ajrosje, kishte lagështi, erë të rëndë nga përdorimi i mjeteve të ndryshme kimike të cilat nuk janë adekuate për pastrim. Kishte probleme me paisje të cilat nuk punojnë dhe punëtorët e lavanterisë janë të detyruar të improvizojnë rregullimin e ndonjëres nga këto pajisje për të kryer punën. Po ashtu, personat që punojnë në lavanteri nuk kanë rroba pune, maska e as ushqim adekuat për kushtet në të cilat punojnë.

### **Kushtet e akomodimit në pavijone**

18. Kushtet e akomodimit dallojnë nga pavijoni në pavijon. MKPT ka vërejtur se pavijoni 1 është rinovuar, tualetet dhe dushet ishin në gjendje të mirë, qelitë nuk kishin lagështi, ishin të gëlqerosura dhe të pastra. Qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim të mjaftueshëm, si dhe ventilim. Gjatë vizitës, MKPT i kushtoi vëmendje të veçantë të burgosurve të cilëve u ishte shqiptuar masa e vetmisë për shkak të shkeljeve disiplinore dhe të cilët mbaheshin në këtë pavijon.
19. Në rastin e të burgosurit R.B, në qelinë ku ishte i vendosur i burgosuri tualeti ishte i bllokuar, dysheku mbi krevatin ku flinte i burgosuri nuk kishte çarçaf fare, qelia kishte ndriçim të mjaftueshëm dhe nuk kishte lagështi. Të njëjtat kushte akomodimi u gjetën edhe në rastin e të burgosurit G.A i cili po ashtu ishte i ndëshkuar me masën disiplinore të vetmisë. MKPT vëren se Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se dhoma për ekzekutimin e vetmisë duhet të ketë një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metra kub, pajisje sanitare, dritë natyrore, ujë të pijshëm, shtrat me çarçaf, tavolinë, karrige dhe ngrohje.<sup>3</sup> **Prandaj, MKPT konsideron se QKD duhet të përmbush këtë kriter ligjor në të gjitha rastet kur të burgosurve u shqiptohet masa disiplinore e vetmisë.**

---

<sup>3</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 111, paragrafi 2.

20. Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm “KPT”), lidhur me kushtet e akomodimit në qeli ku mbahet i burgosuri të cilit i shqiptohet masa disiplinore e vetmisë, thekson se qelitë e tilla duhet të plotësojnë standardet e njëjta minimale si ato të cilat zbatohen në rastet e akomodimit të të burgosurve të tjerë. Ato duhet të jenë të madhësisë adekuate, të kenë dritë natyrore, të kenë ngrohje adekuate dhe ventilim. KPT më tej thekson se qelitë e tilla duhet të jenë së paku të pajisura me tavolinë, karrige adekuate, krevat adekuat dhe çarçaf.<sup>4</sup>
21. MKPT gjatë vizitës ka vërejtur se në pavijonin 2 nevojiten renovime pasi që kishte qeli dhe salla të ngrënies të cilat mbanin lagështi; dushet dhe tualetet po ashtu ishin në gjendje të keqe. **Gjatë vizitës është vërejtur se të burgosurit përdorin pajisje elektrike të improvizuara për ngrohje të ujit të cilat mund të rrezikojnë seriozisht jetën e tyre.** MKPT vëren se edhe Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës gjatë vizitës në Kosovë në vitin 2015 shprehu shqetësimin për shkak të përdorimit të pajisjeve elektrike të improvizuara nga të burgosurit në QKD dhe kërkoi nga autoritetet relevante të Republikës së Kosovës të ndërmarrin hapa konkret për evitimin e përdorimit të pajisjeve të tilla.<sup>5</sup>
22. Po ashtu, MKPT ka vërejtur se disa qeli nuk i plotësojnë standardet minimale të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës lidhur me madhësinë e qelisë dhe numrin e të burgosurve të akomoduar.<sup>6</sup> Pavijoni 4 ishte në renovim e sipër. Kushtet e akomodimit në pavijonin numër 7 përgjithësisht janë shumë të mira dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare. MKPT ka vërejtur se në pavijonin 6 tualetet e përbashkëta janë shumë të dëmtuara dhe ka mungesë të ujit të ngrohtë. **Në disa qeli janë të vendosur 6 persona, gjë që përbën mbipopullim. MKPT konsideron se QKD duhet të ndërmerr hapa për të evituar raste të mbipopullimit duke bërë sistematizimin e duhur të të burgosurve.**
23. MKPT ka vizituar pavijonin 8 në të cilin vendosen të sapo pranuarit dhe i nënshtrohen një regjimi themelor i cili zgjat 28 ditë. Kushtet e akomodimit në këtë pavijon janë shumë të këqija dhe lehtë mund të barazohen me trajtim degradues, poshtërues dhe çnjerëzor. MKPT vëren se neni 36, paragrafi 1 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë në strehim që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike”*. Ndërsa në paragrafin 3 të këtij neni shprehimisht përcaktohet: *“Lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje adekuate sanitare dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale”*.
24. MKPT shpreh shqetësim serioz lidhur me faktin se një pjesë e pavijonit numër 8 shfrytëzohet si krah i spitalit. Në krahun V1 të pavijonit nr.8, MKPT ka intervistuar disa

<sup>4</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga raporti i 21-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2011, për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>, (21.5.2018)

<sup>5</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 38. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>, (21.5.2018).

<sup>6</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36 paragrafi 2 përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra kub hapësirë dhe kur është e mundshme nëntë (9) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të vetme, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje”*. Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës lidhur me standardet për madhësinë minimale të qelisë të përcaktuara në vitin 2015 përcakton standardin minimal të madhësisë së qelisë 6 metra katrorë për të dënuarit në qeli të vetme dhe 4 metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cc449>, (21.5.2018).



të burgosur, ku dy prej tyre ishin me çrregullime kronike psikiatrike dhe njëri prej tyre gati tri vite qëndron vetëm në një qeli. Kjo gjendje është në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1.10 të Ligjit nr. 05/L-025 Për Shëndetin Mendor.<sup>7</sup>

25. Po ashtu, KPT thekson se një i burgosur i sëmurë mendorë duhet të mbahet dhe përkujdeset në një mjedis spitalorë që është i pajisur përshtatshëm dhe që ka personelin e trajnuar siç duhet. Ai mjedis mund të jetë një spital psikiatrik civil ose një mjedis psikiatrik i pajisur posaçërisht brenda sistemit të burgut<sup>8</sup>.
26. MKPT konstaton se pavijoni 8 nuk përmbush standardet minimale të akomodimit të parapara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligjin për Shëndetin Mendor, standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Konventat tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.
27. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT u njoftua nga të burgosurit në të gjitha pavijonet se atyre nuk u open çarçafë dhe se ata duhet t'i sjellin nga familjet e tyre, kurse, batanijet u jepen nga QKD.<sup>9</sup> **Autoritetet relevante duhet të veprojnë në pajtim me obligimet të cilat burojnë nga neni 16 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.**
28. MKPT ka vërejtur se edhe më tej të burgosurit po thuajse në të gjitha pavijonet detyrohen t'i mbajnë gjësendet e tyre në qese plastike apo pako të kartonit, meqenëse hapësirat që i kanë në dispozicion nuk u mjaftojnë. Edhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 ka konstatuar të njëjtin problem dhe ka kërkuar nga autoritetet relevante që kjo mangësi të evitohet.<sup>10</sup>

## Regjimi

29. QKD ofron 4 regjime për të burgosurit: regjimi themelorë, standard, të avancuar dhe gjysmë të hapur. Në QKD, sipas drejtorisë janë rreth 350 të dënuar të angazhuar në punë. Angazhimi në punë është më i madh gjatë stinës së verës. Zakonisht të dënuarit angazhohen në punë në kuzhinë, pastrim dhe në ferma të qendrës. Të dënuarit mund të lëvizin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur dhe kanë të drejtë 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit 2 orë në ditë.<sup>11</sup>
30. Po ashtu, në kuadër të qendrës korrektuese funksionojnë 3 punëtori që në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, ndërtimtari, axhustator, zdrukthëtar, mirëmbajtje teknike, instalim i ujit dhe rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse me kohëzgjatje prej 3 muajve.
31. Në kuadër të QKD ekziston edhe salla e fitnesit, basketbolli dhe fusha e futbollit. Salla e basketbollit për momentin nuk përdoret meqenëse duhet të ndërrohen xhamat e dëmtuar

<sup>7</sup> Neni 6, paragrafi 1.10 i Ligjit nr. 05/L-025 Për Shëndetin Mendorë, përcakton “të drejtën për t’u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë”.

<sup>8</sup> Normat e KPT, Pjesë nga Raporti i 3-të i Përgjithshëm. [CPT/Inf (93) 12], paragrafi 43

<sup>9</sup> Neni 16 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese: “*Secili person i dënuar e ka shtratin e vetë, që përbëhet prej krevatit ose shtratit të posaçëm, dyshekun, jastëkun me këllëfin, dy çarçafë dhe një ose dy plafa së verës respektivisht dy (2) deri në tre (3) plafa gjatë periudhës së dimrit, varësisht nga ngrohja. Secili person i dënuar ngarkohet me shtratin e vet, me sendet që e përbëjnë shtratin dhe me dollapin për sendet personale*”.

<sup>10</sup> Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti nga vizita në Kosovë në vitin 2015, publikuar në shtator 2016.

<sup>11</sup> Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë në së paku dy orë shëtitje.

dhe të vendosen rrjeta të cilat do të parandalonin dëmtimet e xhamave që shkaktohen si pasojë e goditjeve me top. Një pjesë e sallës, siç janë tualetet dhe dushet ishin rinovuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, kurse në pjesën tjetër punimet janë ndalur pasi që kryerësi i punëve nuk i ka respektuar kushtet teknike. **Prandaj, gjendja në këto objekte mbetet e njëjta si edhe gjatë vizitës në nëntor të vitit 2016.**

32. Po ashtu, MKPT konsideron se krijimi i njësisë ekonomike do të shtonte aktivitetet dhe angazhimet e një numri më të madh të të dënuarve. Krijimi i njësisë ekonomike parashihet edhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.<sup>12</sup>
33. **Pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë së QKD, MKPT është e mendimit se me qëllim të arritjes së risocializimit dhe rehabilitimit të duhur të të dënuarve duhet të rriten aktivitetet e mirëfillta dhe të ketë sa më shumë programe rehabilitimi të cilat do të ishin në dispozicion të një numri sa më të madh të të dënuarve.**

### **Kujdesi shëndetësorë**

34. Në Qendrën Korrektuese në Dubravë funksionon spitali i burgut i cili ofron shërbime mjekësore për të burgosurit ku janë angazhuar 6 mjek të rregullt, (një mjek është në dispozicion gjatë 24 orëve), 26 infermierë, të cilët punojnë në ndërrime nga 12 orë. Po ashtu, dy herë në javë ofrohen shërbime nga fiziatrit, kurse fizioterapeutja është infermiere e trajnuar për fizioterapi e cila punon çdo ditë me orar të plotë.
35. MKPT në raportin e fundit për QKD<sup>13</sup>, të publikuar më 26 janar 2017, i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) që të angazhojë edhe një psikolog, pasi që është e pamundur të mbulohet tërë qendra me një psikolog, të angazhojë një stomatolog të rregullt dhe një psikiatër të rregullt. Gjatë vizitës së fundit u konstatua se QKD ka të angazhuar dy psikolog me orar të plotë. **MKPT përshëndet zbatimin e rekomandimit për angazhimin e psikologut shtesë.** Kurse, stomatologu deri tani ishte i rregullt, por meqenëse ka filluar specializimin tani punon në QKD dy herë në javë.
36. Si konsultantë të jashtëm të cilët punojnë një herë në javë, janë të angazhuar: psikiatri, kardiologu, ortopedi, neurologu, radiologu dhe tekniku i radiologjisë, fizitari, oftamologu, otorinolaringologu, ndërsa kirurgu i përgjithshëm ftohet sipas nevojës. MKPT është informuar se në kuadër të shërbimit shëndetësor e realizon edhe programin e trajtimit me Metadon.
37. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT ka vërejtur se spitali edhe më tej nuk posedon ashensor përmes së cilit do t'u mundësohej qasja në katin e dytë të të dënuarve me aftësi të kufizuara. Autoritet e Republikës së Kosovës në përgjigjen e tyre dërguar KPT lidhur me konstatimin në raportin e KPT për vizitën në Kosovë se të dënuarit me aftësi të kufizuara nuk kishin qasje adekuate në spital, kanë theksuar se çështja i është adresuar Shërbimit Korrektues të Kosovës për të evituar këtë mangësi dhe për të vendosur një ashensorë. Më tej në përgjigjen e autoriteteve theksohet se kjo gjë nuk do të bëhet gjatë këtij viti bazuar në buxhetin e tanishëm dhe planet për rekonstruim të Shërbimit Korrektues.
38. MKPT ka vërejtur se higjiena në dhoma të spitalit në pjesën ku mbahen pacientët për trajtim psikiatrik nuk ishte në nivelin e duhur. Po ashtu, shtretërit në dhomat e spitalit dhe mbulesat janë të vjetërsuara dhe të pa pastra. **Pacientët janë të vendosur pa kritere**

<sup>12</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 212-214.

<sup>13</sup> [http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/27012017,Raport\\_me\\_rekomandime\\_i\\_MKPT\\_-\\_Dubrav%C3%AB\\_101537\\_457637.pdf](http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/27012017,Raport_me_rekomandime_i_MKPT_-_Dubrav%C3%AB_101537_457637.pdf)



**të identifikuara sipas gjendjes së tyre shëndetësore dhe mendore, numrit nëpër dhoma.**

39. MKPT gjatë vizitës në vitin 2016 u njoftua nga shërbimi mjekësor se problem shqetësues paraqitet pamundësia për t'i dërguar të burgosurit që kërkojnë shërbime mjekësore jashtë qendrës për shkak të mungesës së transportit të rregullt. Gjatë kësaj vizite u konstatua se QKD posedon një auto ambulancë e cila nuk i plotëson kushtet dhe nuk është plotësisht funksionale dhe nuk i posedon gjërat elementare për dhënien e ndihmës mjekësore adekuate. Më 29 maj 2018, Drejtoria e Shëndetësisë në Burgje e njoftoi MKPT se tani janë pajisur me një auto ambulancë të re.
40. Edhe pse spitali i burgut u rinovua më herët, megjithatë MKPT ka vërejtur se infrastruktura është dëmtuar dukshëm (pallakat e dyshemesë dhe inventari në korridorin e sallës ku ushqehen pacientët), ndërsa pjesa e ndarë si kuzhinë për përdorim të pacienteve të shtrirë është e papërdorshme. Këto dëmtime janë pasojë e punimeve jo kualitative të kryera nga kompania e angazhuar, të cilat janë pranuar teknikisht. **MKPT konsideron se janë të domosdoshme rinovimet në spitalin e burgut.**

### **Regjistrat e spitalit**

41. Spitali i burgut mban regjistrat, si në vijim: regjistër për vetëlëndim, regjistri i grevës së urisë, regjistri i tentim vetëvrasjeve, lëndimeve trupore, regjistri i vdekjeve në burgje dhe abuzimeve seksuale. Gjithashtu, secili mjek posedon protokollin e vizitave të pacientëve. MKPT ka vërejtur se spitali posedon pajisje moderne dhe mund të ofrojë shërbime adekuate mjekësore për të burgosurit. Në përgjithësi, MKPT konstaton se përbërja e personelit dhe pajisjet në dispozicion të spitalit të burgut i plotësojnë standardet për ofrim të shërbimeve adekuate mjekësore, por ambienti ku akomodohen të sëmurët mendorë si dhe ata me sëmundje organike, nuk është i përshtatshëm (shih paragrafin 23, 24, 25 dhe 26 të raportit). Sa i përket regjistrave dhe dosjeve, evidentimeve të tjera të shërbimeve shëndetësore, MKPT konsideron se janë në nivel të kënaqshëm.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

42. MKPT është interesuar nëse personeli mjekësor të dënuarve në Qendrën Korrektuese në Dubravë u ofron shërbimet mjekësore në prezencë të zyrtarëve korrektues. Gjatë vizitës në spital MKPT konstatoi se shërbimet mjekësore në spitalin e burgut jepen pa prezencë të zyrtarëve korrektues, përveç rasteve kur prezenca e zyrtarëve korrektues kërkohet shprehimisht nga personeli mjekësor. ***MKPT inkurajon një qëndrim dhe praktikë të tillë të mos prezencës së zyrtarëve të sigurisë gjatë dhënies së shërbimeve mjekësore.***<sup>14</sup>

### **Çështje të tjera**

#### **Personeli i Qendrës Korrektuese në Dubravë**

43. Gjatë kësaj vizite MKPT ka pranuar shqetësimet e drejtorisë për shkak të mungesës së personelit korrektues, punëtorëve social dhe psikologëve. Sipas drejtorisë, momentalisht QKD ka të angazhuar rreth 60 zyrtarë korrektues të angazhuar në ruajtjen e personave me sëmundje kronike të cilët janë të shtrirë në ente shëndetësore dhe një numër i zyrtarëve korrektues shkollohen në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri. Afërsisht

---

<sup>14</sup> Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për Kosovën pas vizitës në Kosovë në vitin 2015, pati vërejtje lidhur me ofrimin e shërbimeve mjekësore në prezencë të zyrtarëve korrektues dhe rekomandoi ndërprerjen e praktikave të tilla.

100 zyrtarë korrektues i mungojnë QKD-së sipas drejtorisë. Po sipas drejtorisë planifikohet shtimi i personelit korrektues për 50 zyrtarë të rinj. Po ashtu, drejtoria ka shprehur shqetësimin lidhur me moshën mesatare të personelit korrektues, e cila është 49 vjeç.

44. Gjatë vizitës, MKPT ka pranuar shumë ankesa edhe nga personeli korrektues lidhur me numrin e vogël të zyrtarëve korrektues në raport me të burgosurit dhe kushteve tjera të punës. Një nga ankesat e shumta është edhe mos furnizimi me uniforma dhe pajisje tjera të domosdoshme për të kryer punën e tyre.
45. MKPT konsideron se mënyra se si personeli e percepton kualitetin e jetës në punë dhe mënyra se si ata trajtohen nga menaxherët dhe kolegët e tyre ka një ndikim të rëndësishëm në atmosferën në burg dhe në trajtimin e të burgosurve. Zyrtarët korrektues të cilët ndjehen të çmuar, të besueshëm dhe të respektuar në vendin e tyre të punës kanë gjasa më të mëdha që këto vlera t'i zbatojnë edhe në trajtimin e të burgosurve. Kushtet e favorshme të punës në burg po ashtu janë të rëndësishme për të tërhequr dhe mbajtur personelin e duhur në burg.
46. Standardet ndërkombëtare në këtë aspekt janë të qarta dhe përcaktojnë se personeli në burgje duhet të emërohet me orar të plotë të punës, të kenë status civil, të kenë paga adekuate dhe benefite të favorshme të punësimit dhe kushte adekuate për të kryer shërbimin e tyre. Pagat e vogla, kushtet jo adekuate të punës dhe mungesa e benefiteve tjera të cilat janë të nevojshme për të stimuluar punën adekuate në ambiente siç janë burgjet mund të kenë ndikim negativ në motivimin dhe kryerjen e detyrave nga personeli i angazhuar në punë në burgje. Përveç kësaj, një situatë e tillë mund të nxisë korrupsionin.<sup>15</sup>
47. Po ashtu, një nga ankesat e shpeshta të cilat i pranon MKPT nga zyrtarët korrektues është edhe çështja e llogaritjes së stazhit të beneficuar. MKPT vëren se neni 221 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: *“Zyrtarët korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave”*. **MKPT kërkon të njoftohet nga organet kompetente lidhur me këtë çështje.**
48. MKPT ka vizituar edhe objektin ku është e stacionuar Njësia Speciale Intervenuese e cila përbëhet nga 17 pjesëtarë, të cilët punojnë në ndërrime nga 12 orë dhe janë në thirrje 24 orë. Në nivelin qendrorë është vetëm ky njësit dhe i njëjti kryen punë si: bastisjet e veçanta, patrullime për punë të sigurisë, ndërhyr kur ka eskalim të situatave në QKD si dhe në burgje tjera. Ky njësit kryenë edhe punët e transportit, bastisjet e mallit që hynë në QKD, por që nuk përshkruhet në detyrat e tyre të punës.
49. MKPT vizitoi edhe hapësirën e objektit ku ata kryejnë edhe ushtrimet praktike. Në përgjithësi objekti i plotësonte kushtet për punë dhe akomodim të njësitit. Sa i përket ushqimit dhe kategorisë së rrezikshmërisë, ky njësit trajtohet njëjtë sikur zyrtarët tjerë korrektues brenda QKD. Për 12 orë pune dhe ushtrime praktike që bëjnë, njësitit merr vetëm një shujtë ushqimore (sipas pohimeve të tyre, në të kaluarën ata e kishin edhe një shujtë shtesë), dhe kjo nuk është e mjaftueshme për ta.

---

<sup>15</sup> Rregullat e Mnadelës, Rregulli 74. Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 79.1 dhe Rregulli 79.2. Raporti i 10-të dhe i 11-të i Përgjithshëm i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës.

50. Sa i përket pajisjeve, njësitë përdorë *peper spray*, të cilët i ka skaduar afati afërsisht 3 vite, shufër dhe pranga. Nuk kanë automatet të tyre, aparat për frymëmarrje, gaz-maskë, radiolidhje. MKPT vërejti se pjesëtarët e kësaj njësie në helmetat e tyre nuk kanë numra identifikues. MKPT konsideron se është vështirë të pritët që ky njësit me këtë përbërje dhe me gjithë këto angazhime të kryej detyrat në të gjitha vendet ku angazhohet për të kryer detyra specifike. Sa i përket përdorimit dhe afatit të skaduar të *peper spray* situata mbetet e njëjtë ashtu siç është konstatuar edhe në raportin me rekomandime të publikuar më 26 janar 2017.<sup>16</sup>

### **Masat disiplinore**

51. Sipas legjislacionit në fuqi dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>17</sup> Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, Avokatin e Popullit dhe misionet diplomatike. Gjatë vizitës, me qëllim të analizimit të gjendjes në këtë aspekt, MKPT ka analizuar disa vendime të drejtorisë së QKD me të cilat të burgosurve të caktuar iu shqiptuan masa të ndryshme disiplinore, përfshirë edhe masën disiplinore të vetmisë.
52. MKPT konstatoi se QKD mban regjistër për masat e shqiptuara disiplinore ku shënohen të dhëna lidhur masën e shqiptuar, arsyen, kohën e shqiptimit dhe mbarimit. Po ashtu, këto vendime disiplinore u dorëzohen edhe të burgosurve dhe përmes të njëjtave ata njoftohen për mjetet juridike në dispozicion, në qoftë se janë të pakënaqur me masën disiplinore të shqiptuar.
53. MKPT u njoftua se shërbimi mjekësor nuk merr pjesë në marrjen e vendimit lidhur me aftësinë e të paraburgosurit apo të dënuarit për të përballuar masën disiplinore të vetmisë. MKPT konsideron se personeli mjekësorë e ka të qartë rolin e tij në këtë aspekt. Pjesëmarrja e mjekut në vendimmarrje, i cili në fakt është mjeku i personit të paraburgosur apo dënuar, do të minonte raportin mjek-pacient, përveç nëse kjo masë ndërmerret për arsye mjekësore.<sup>18</sup>
54. Por, MKPT edhe përmes këtij raporti (sikur edhe në raportet tjera me rekomandime të publikuar më herët) shpreh shqetësimin për faktin se legjislacioni në fuqi<sup>19</sup> parasheh që, para se i burgosuri të vendoset në vetmi drejtori i institucionit korrektues të kërkojë me shkrim mendimin e mjekut i cili dëshmon se i dënuari është në gjendje të mirë shëndetësore fizike dhe psikike për t'iu nënshtruar masës disiplinore të vetmisë.
55. **MKPT sërish kërkon nga autoritet relevante që dispozitat në fuqi të këtyre akteve të ndryshohen në pajtim me rekomandimin e KPT në raportin për Kosovën, në pajtim me raportin e përgjithshëm të 21-të të KPT dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec (2006) 2 për Rishikimin e Rregullave Evropiane të Burgjeve, me të cilën kërkohet mendimi me shkrim se i burgosuri mund t'iu nënshtrohet kësaj mase, u largua.**

---

<sup>16</sup> [http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/27012017,Raport\\_me\\_rekomandime\\_i\\_MKPT\\_-\\_Dubrav%C3%AB\\_101537\\_457637.pdf](http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/27012017,Raport_me_rekomandime_i_MKPT_-_Dubrav%C3%AB_101537_457637.pdf) (25.5.2018).

<sup>17</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>18</sup> Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka kërkuar nga autoritetet relevante që të ndërpritet praktika e kërkesës nga mjeku vërtetim se i paraburgosuri apo i dënuari është në gjendje për ta përballuar masën.

<sup>19</sup> Neni 107 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe neni 76 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institutet Korrektuese.

## **Kontakti me botën e jashtme**

56. Legjislacioni në fuqi<sup>20</sup>, në rastin e personave të dënuar përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj e cila zgjatë minimum një orë, si dhe në vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre së paku një herë në 3 muaj me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.
57. Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>21</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta).
58. Të dënuarit në regjim themelor mund t'i lejohet një telefonatë gjatë javës e cila zgjatë 15 (pesëmbëdhjetë minuta), ndërsa të dënuarve në regjim të avancuar mund tu lejohen dy thirrje telefonike të cilat zgjasin 15 (pesëmbëdhjetë minuta).
59. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit” bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.
60. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund të vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen MKPT të Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.
61. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilit e ka ai/ajo.<sup>22</sup> Gjatë vizitës, MKPT i ka intervistuar disa shtetas të huaj (nga Republika e Shqipërisë) të cilët MKPT-së iu ankuan lidhur me të drejtën për të shfrytëzuar të drejtën për vikende e cila për shtetasit e huaj, u pezullua me një vendim të Ministrisë së Drejtësisë. Shtetasit e huaj nuk patën ankesa tjera lidhur me të drejtat tjera të të burgosurve. **MKPT nuk ka pranuar ankesa lidhur me të drejtën për kontakte me botën e jashtme.**

## **Hapësirat ku pranohen vizitat**

62. Gjatë vizitës, MKPT ka vizituar edhe hapësirat ku pranohen vizitat familjare dhe vizitat e lira. Kushtet në këto hapësira mbeten në nivel të kënaqshëm dhe MKPT nuk ka pranuar ankesa as nga të burgosurit dhe as nga vizitorët të cilët gjendeshin në këto hapësira gjatë vizitës.

<sup>20</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

<sup>21</sup> Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

<sup>22</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33 paragrafi 1.

## Procedurat e pranimit

63. Në QKD, të sapo pranuarit u nënshtrohen procedurave të pranimit e cila zgjatë më së shumti deri 30 ditë. Gjatë kësaj periudhe ata vlerësohen dhe kategorizohen në qeli të veçanta, para se të akomodohen nëpër qeli të zakonshme. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se QKD posedon regjistër në të cilin evidentohen të dhëna lidhur me të burgosurit e vendosur në pavijonin e pranimit. Sa i përket kontakteve me botën e jashtme dhe shëtitjeve gjatë kësaj periudhe, të burgosurit deklaruan se u lejohen dy telefonata dhe 2 vizita gjatë periudhës sa ata janë të vendosur në këtë pavijon.

## Kontrulli mjekësor gjatë pranimit

64. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore sidomos në rastet e të burgosurve apo të paraburgosurve të sapo-pranuar, jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili epet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.
65. QKD e njoftoi ekipin e MKPT se, të sapo pranuarit kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në qendër. Këto kontrolle nënkuptojnë një kontrollë të përgjithshëm dhe gjatë së cilës i burgosuri pyetet nëse ka ndonjë sëmundje e cila, nëse deklarohet, regjistrohet në dosjen e tij mjekësore. Të gjitha procedurat e shërbimit shëndetësorë në burgje behën bazuar në Praktikën Standarde të Veprimt. Ky dokument zyrtar u përpilua në bashkëpunim ndërmjet ekspertëve vendorë me ekspertët e fushës nga Këshilli i Evropës dhe filloi të zbatohet nga tetori i vitit 2017

## Çështje të ndërlidhura me sigurinë

66. Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur se edhe më tej i ashtu quajtur *peper spray* është pjesë e pajisjeve standarde të zyrtarëve të caktuar korrektues në QKD . Përveç kësaj, MKPT u njoftua se ky *peper spray* është me afat të skaduar. KPT në raportet për vizitat në Kosovë në vitin 2010 dhe 2015 ka kërkuar nga autoritet relevante që të ndërpritet kjo praktikë duke pasur parasysh efektet dëmtoese që kanë substancat dhe që kjo pajisje të mos jetë më pjesë e pajisjeve standarde të zyrtarëve korrektues. **MKPT kërkon nga QKD të dërgojë komentet lidhur çështjen e përdorimit të *peper spray* dhe nëse i njëjti është pajisje standarde e secilit zyrtar korrektues apo vetëm e zyrtarëve të caktuar.**
67. MKPT u njoftua nga drejtoria, se në disa pavijone dhe objekte në QKD nuk ka kamera të sigurisë dhe se disa kamera janë jashtë funksionit. **MKPT inkurajon autoritetet e QKD që të pajisin të gjitha korridoret e pavijoneve dhe hapësirave të jashtme me kamera të sigurisë të cilat, sipas KPT, në fakt përbëjnë një nga garancitë për mbrojtje nga keqtrajtimi.**<sup>23</sup> Në raportin për Irlandën në vitin 2010, KPT inkurajon autoritet relevante të instalojnë sa më shumë kamera të sigurisë në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria.
68. **Edhe përmes këtij raporti, MKPT inkurajon autoritetet relevante që sigurojnë mundësi teknike që të dhënat e regjistruara nga kamerat e sigurisë të ruhen një kohë më të gjatë pasi që në këtë mënyrë mund të hetohen në mënyrë më efektive pohimet eventuale për keqtrajtim apo përdorim të tepruar të forcës fizike.**

---

<sup>23</sup> KPT, raporti për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.



## **Incidentet ndërmjet të burgosurve**

69. Sipas drejtorisë, gjatë këtij viti, deri më tani janë regjistruar katër incidente ndërmjet të burgosurve. MKPT ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës. Në përgjithësi, MKPT gjatë vizitës ka vërejtur se raportet ndërmjet të burgosurve janë të mira dhe nuk ka klimë tensionimi shqetësues ndërmjet tyre pothuajse në asnjë pavijon.

## **Procedura e parashtrimit të ankesave**

70. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

71. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshinë edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministria e Drejtësisë.<sup>24</sup>

72. MKPT ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QKD janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.

**73. MKPT ka pranuar ankesa nga të dënuarit lidhur me mos përgjigjen në kërkesa të cilat i drejtohen drejtorisë. MKPT konsideron se pavarësisht natyrës së kërkesës është e rëndësishme që të burgosurve t'u kthehen përgjigje në kërkesat e parashtruara.**

74. MKPT është e njoftuar se Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me ekspertët e Këshillit të Evropës në kuadër të projektit të përkrahjes për Shërbimin Korrektues të Kosovës, kanë mbajtur disa punëtori me qëllim të ndërtimit të procedurave dhe përpilimit të formularëve të ankesave të të burgosurve.

## **Ankesat kundër Panelit për Lirim me Kusht**

75. Gjatë vizitës, ekipi monitorues ka pranuar një numër të madh të ankesave kundër vendimeve të Panelit për Lirim me Kusht (PLK). **Sipas pohimeve të ankuesve PLK nuk ua dërgon në QKD vendimet lidhur me kërkesën e tyre për lirim me kusht.**

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

---

<sup>24</sup> Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.



## **Ministria e Drejtësisë:**

1. Të njoftojë MKPT të Avokatit të Popullit nëse është miratuar legjislacioni sekondar për luftimin e korrupsionit.
2. Të përmirësohet cilësia dhe sasia e ushqimit.
3. Të burgosurve t'u sigurohet ushqimi dietal sipas rekomandimit të mjekut kompetent.
4. Të gjitha qelitë ku vendosen të burgosurit të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e vetmisë të jenë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës. (shih paragrafët 19 dhe 20 të këtij raporti).
5. Të bëhen renovimet e nevojshme bazuar në konstatimet në këtë raport, veçanërisht pavijoni 8.
6. Të furnizohet kuzhina me pajisje adekuate sipas vlerësimit konkret.
7. Të ndërmerren hapa konkret në mënyrë që të ndërpritet praktika e përdorimit të pajisjeve të improvizuara elektrike.
8. MKPT ripërsërit rekomandimin që të burgosurit të furnizohen me dollapë për vendosjen e gjësendeve të tyre (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017).
9. MKPT ripërsërit rekomandimin që të funksionalizohet salla e sportit. (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017)
10. Të funksionalizohet njësia ekonomike.
11. MKPT ripërsërit rekomandimi që në spitalin e burgut të instalohet ashensori i cili do t'u mundësonte të burgosurve me aftësi të kufizuara qasjen në katin e dytë të spitalit (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017).
12. Të bëhen renovimet e nevojshme në spital (shih paragrafin 40 të këtij raporti).
13. Të angazhohet personeli i nevojshëm korrektues sipas vlerësimit të nevojave.
14. MKPT ripërsërit rekomandimin që vendosen kamerat e sigurisë aty ku mungojnë, si dhe mundësinë teknike të ruajtjes së të dhënave për një kohë më të gjatë (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017).
15. MKPT ripërsërit rekomandimin që të bëhet plotësim/ndryshimi i LESP dhe Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, ku parashihet që të kërkohet mendimi me shkrim i mjekut, para se një personi t'i shqiptohet masa disiplinore; (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017).
16. Të shtohet numri i punëtorëve social bazuar në numrin e të burgosurve në QKD.
17. Të furnizohet QKD me të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për punë të përditshme.
18. Të adresohen nevojat e zyrtarëve korrektues sa i përket kushteve të punës dhe pajisjeve për punë.
19. Të njoftohet MKPT lidhur me çështjen e përdorimit të *peper spray* dhe afatit të skaduar të të njëjtit. (shih paragrafin 67 të këtij raporti)

**Ministria e Shëndetësisë:**

20. **MKPT ripërsëritë rekomandimin që Ministria e Shëndetësisë të angazhojë një stomatolog të rregullt (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017).**
21. **MKPT ripërsëritë rekomandimin që Ministria e Shëndetësisë të angazhojë një psikiatër të rregullt (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017).**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit